



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0840

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare, Isa Hasani Anetar dhe Batisha Ibrahim Anetare duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Komplast 1985” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “Komuna Prishtinë” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “141 Ndërtimi i sistemit të ujitjes në hapësira gjelbëruese dhe hapja e puseve” me numër të prokurimit 616-25-3717-5-1-1, me 04/11/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Komplast 1985” SH.P.K. me nr. 2025/0840, e datës 01/09/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “141 Ndërtimi i sistemit të ujitjes në hapësira gjelbëruese dhe hapja e puseve” me numër të prokurimit 616-25-3717-5-1-1.

2. Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin e AK të “Komuna Prishtinë”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “141 Ndërtimi i sistemit të ujitjes në hapësira gjelbëruese dhe hapja e puseve” me numër të prokurimit 616-25-3717-5-1-1.

3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 06.05.2025, “Komuna Prishtinë” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftim për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “141 Ndërtimi i sistemit të ujitjes në hapësira gjelbëruese dhe hapja e puseve” me nr. të prokurimit: 616-25-3717-5-1-1. Ndërsa me datën 12.08.2025 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie. OE “Kom Group SH.P.K: Fidani L SHPK: Company Murseli SHPK.”- Prishtinë

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 700,000.00 €.

Me 18.08.2025, OE “Komplast 1985” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. E cila me vendimin e AK me datën 20.08.2025 është refuzuar si te pa bazuar Kërkesën për Rishqyrtim.

Me 01/09/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Komplast 1985” SH.P.K me nr. 2025/0840 për lidhur me aktivitetin “141 Ndërtimi i sistemit të ujitjes në hapësira gjelbëruese dhe hapja e puseve” me nr. të prokurimit: 616-25-3717-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Komplast 1985” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Me Vendimin e publikuar me dates 12.08.2025 ne forumularin B-58-NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK[1]se.PDF, Autoritetit Kontraktues (AK)- KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES përmes të cilit e kishte shpallë operator Ekonomik të Përgjegjshëm dhe të Suksesshëm GOE Kom Group Shpk, Fidani L Shpk & Company Murseli, ndersa neve si konzorcium “Komplast 1985” Sh.p.k. & Berisha Com Shpk & Komplast Shpk na kishte shpallur të pa suksesshëm.

Kundër Vendimit (Njoftimit) të lartcekur ne si GOE kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim e cila u refuzua nga AK duke e marrur si te pabazuar me Vendimin e dates 20.08.2025.

Të nderuar me dt. 07.05.2025 është publikuar tenderi me titull 141 Ndërtimi i sistemit të ujitjes në hapësira gjelbëruese dhe hapja e puseve me nr.prok: 616-25-3717-5-1-1

Rekomandimi për kontratë:

Ne kemi pranuar letrën standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si më poshtë:

Pretendimi 1 -Tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale në dosje të tenderit është kërkuar:

Kërkesa 4. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit; Aneksin 10 te DT.

Evidenca 4. Një listë të mjeteve apo pajisjeve teknike që janë në dispozicionin tuaj për të ekzekutuar kontratën në fjalë – pajisjet dhe makineria në dispozicion duhet të dëshmohen me kopje të libereve mbi pronësinë e tyre ose DUD-i doganor. Në rast të marrjes me qera duhet të dëshmohet edhe me kontratë mbi qeramarrjen.

Për të plotësuar këtë kërkesë ne kemi paraqitur Listën e makinerisë të nënshkruar dhe vulosur ku kemi listuar të gjitha makineritë me të dhënat dhe pronësinë e tyre konform kërkesës së dosjes së tenderit mirëpo dokumentet e tyre nuk ishin ngarkuar në e-prokurim për shkak të problemeve teknike me rrjetin dhe të njëjtat po i përcjellim tani ashtu si kemi paraqitur në këtë listë. Të njëjtat dëshmi i kemi bashkëngjitur edhe me kërkesë për rishqyrtim.

Në këto raste mund të kërkohen sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, pasi që në këto dispozita ceket qartë se mbi cilin do aspekt të tenderit mund të kërkohen sqarime.

Pretendimi 2 -Tek Siguria e tenderit është kërkuar: Shuma e Sigurimit të Tenderit është[shëno shumën në fjalë dhe shifra] 9100 € për periudhë valide prej në ditë: 150

Për të plotësuar këtë kërkesë ne me date 26.05.2025 kemi paguar sigurimin konform kësaj kërkesë dhe e kemi pas të gatshëm për ngritje në system, mirëpo i njëjti nuk ishte ngarkuar për shkak të problemeve teknike që kemi pasur sikurse edhe lista e lartcekur. Ky sigurim konsiderojmë se është valid pasi është bere me datën e njëjtë të aplikimit dhe para skadimit të afatit për aplikim- ora 14: 00. Ky fakt mund të vërtetohet nëse kërkohet sqarime tek kompania e sigurimeve Sigal Uniq Group. Si dëshmi po ua bashkangjesim policen e sigurimit ku vërtetohet arsyetimi ynë.

Pretendimi 3-Tek Kërkesa; Aneksi 7 AFATI I IMPLEMENTIMIT DHE PERIUDHA GARANTUESE

Evidenca 7. Deklaratë e Operatorit Ekonomik për Afatin e Implementimit të projektit dhe Periudhën Garantuese

Konform kësaj kërkesë ne kemi dhënë garancion 5 vite dhe jemi zotuar se afati I implementimit të këtij projekti do të jetë 36 muaj ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit. Ju njoftojmë se edhe ky dokument nuk ishte ngarkuar gjatë aplikimit për arsye të rrjetit dhe të njëjtin po ua ngarkojmë me këtë kërkesë për rishqyrtim.

Vërtetësia e pretendimeve tona për problemet teknike me rrjetin dhe mosngarkimin e këtyre dokumenteve vërehet tek foto e Dosjes për aplikim ku shihet qarte data dhe ora e krijimit të tyre të cilat janë ruajtur te ky folder për aplikim. Shih më poshtë:

Nga dëshmitë që u cekën dhe u bashkëngjiten më lartë vërehet qartë se ne jemi diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit, pasi që nuk janë kërkuar sqarime për dokumentet të cilat nuk kanë qenë të bashkangjitura me ofertë. Neni 72 lejon sqarimet për dokumente të mangëta, të gabuara, jo të plota, prandaj në këtë rast nuk është shfrytëzuar drejtë kjo dispozitë e LPP-së.

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Me eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit dhe me shpalljen fitues të GOE, AK e ka favorizuar GOE të rekomanduar për kontrate ndërsa na ka diskriminuar dhe na ka dëmtuar neve si OE me çmim më lirë pas ofertes se tyre dhe me dokumente në rregull.

- Ne kemi pas qasje në ofertën e grupit të OE të rekomanduar për kontratë Kom Group Shpk, Fidani L Shpk & Company Murseli dhe kemi vërejtë e ky grup është i papërgjegjshëm me arsyte si më poshtë:

Ne dokumentacionin e dorëzuar prej GOE të shpallur fitues në këtë projekt janë paraqitur dy marrëveshje bashkëpunimi me kompanitë PPZ Labinoti dhe NNP SIGMA, të cilat mbajnë datën e vitit 2024 (marrëveshjet në attach). Këto data janë qartësisht të pasakta dhe përbëjnë një element të rëndësishëm që vë në pikëpyetje vlefshmërinë dhe seriozitetin e ofertës së paraqitur.

Poashtu si pike tjetër që paraqet konflikt interesi është Marrëveshja me gjeologun Eflorim Hajra i cili ka shpreh gatishmëri të bashkëpunoj me ne për këtë projekt me Marrëveshjen e datë 25/06/2025. I njëjti çdo herë bashkëpunon me kompaninë tonë nëpër projekte të ndryshme.

Pas kërkesës për sqarim nga AK drejtuar GOE të shpallur fitues në këtë tender ku kërkuan që të paraqesin një Deklaratë nga inxhinieri në fjalë për të vërtetuar se kanë marrëveshje për bashkëpunim, ata kanë paraqitur një deklaratë nga kompania (në attach) dhe jo nga gjeologu Eflorim Hajra i cili na ka ofruar neve këtë deklaratë.

Shih Kërkesën për sqarime nga AK-së dërguar grupit të OE të rekomanduar për kontratë:

Pra kërkesa ka qenë që të kërkohet nga inxhinieri në fjalë se me cilën kompani ka marrëveshje për këtë aktivitet.

Nga dëshmia që ka ofruar grupi i OE për këtë inxhinier kuptohet se ky grup nuk ka mundur të merr deklaratë nga inxhinieri në fjalë prandaj në mungesë të kësaj deklarate, vetë grupi i OE ka dhënë një deklaratë duke konfirmuar se inxhinieri në fjalë është pjesë kompanisë fituese, edhe pse kërkesa e AK-së ka qenë shumë e qartë që të ofrohet dëshmi apo deklaram nga vetë inxhinieri se me cilën kompani ka marrëveshje.

Shih deklaratën e grupit të OE të rekomanduar për kontratë:

Ne e kemi kontaktuar inxhinierin dhe i njëjti na është përgjigjur se pa mëdyshje nuk ka dhënë asnjë lloj aprovimi për të qenë pjesë e asaj oferte (të grupit të rekomanduar për kontratë) dhe se dokumentet e paraqitura nga operatori fitues janë përdorur pa dijeninë dhe miratimin e tij.

Me këtë rast AK-së ka bere shkelje te Ligjit per prokurim publik duke e emëruar per fitues nje GOE te papërgjegjshëm. Deklaratën e inxhinierit Eflorim Hajra ku shpreh përsëri vullnetin e tij te bashkëpunoj me ne, po ua ngarkojmë me këtë Ankese.

Shih deklaratën e inxhinierit Eflorim Hajra të dhënë për kompaninë tonë:

Me këtë dëshmi vërtetohet se inxhinieri në fjalë është pjesë e kompanisë tonë e jo e grupit të OE të rekomanduar për kontratë, prandaj grupi i OE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe është dashur të konsiderohet edhe nga AK-së.

Neni 59.4 e përcakton qartë që një OE mund të konsiderohet përgjegjshëm kur tenderi përputhet në tërësi me kërkesat dosjes së tenderit, kurse në këtë rast kemi mospërputhje të plotë në këtë pikë të tenderit me kërkesat e dosjes së tenderit, prandaj ky grup duhet të shpallet i papërgjegjshëm.

Të dy OE tjerë janë të papërgjegjshëm dhe ne pajtohem me arsyet e eliminimit të tyre. Vendimi për refuzim është nxjerr me dt.20.08.2025 mirëpo që nuk është dhënë asnjë arsye faktike për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, përkitazi me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe me ofertën tonë, prandaj duhet rishqyrtuar edhe njëherë ky aktivitet i prokurimit me të gjitha dëshmitë e ofruara.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se sepse është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik i papërgjegjshëm. Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa jemi diskriminuar ne edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosje së tenderit dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi shpall fitues i këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriteve dhe specifikimeve përkatëse”, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Po ashtu nuk është respektuar neni 6 i LPP-së pasi që ne jemi ofertues më i lirë ndërsa me këtë veprim rrezikohet të dëmtohet buxheti i Komunës.

Çmimi ynë ofertues është 400,64 euro, ndërsa i grupit të OE të rekomanduar për kontratë është 617,77 euro.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "Komplast 1985" SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim nënin 1, 6, 7, 59, 60, 69, 72 dhe nënin 40 të rregullores 001/20252 për prokurim publik. Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të nxjerr: VENDIM I. APROVOHET, e bazuar ankesa e grupit të OE Komplast 1985 Shpk, Berisha Com Shpk & Komplast Sh.p.k ANULOHET njoftimi mbi vendimi e AK-së dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Përgjigje në kërkesën për Rishqyrtim: Operatori ekonomik "Komplast 1985 shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 18.08.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "141 Ndërtimi i sistemit të ujitjes në hapësira gjelbëruese dhe hapja e puseve" me nr. të prokurimit 616-25-3717-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (in nieritum) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

P.I.- "Autoritetit Kontraktues në mënyrë të kundërligjshme na ka eliminuar neve si Grup i Operatoreve: Komplast 1985 Shpk, Berisha Com Shpk & Komplast Sh.p.k. nga ky aktivitet i prokurimit pasi që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit dhe kemi ofruar ofertën me çmim me te lire".

Fillimisht duhet sqaruar se parashtruesi është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për shkak të arsyeve të evidentuara si në vijim:

Ky GOE nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe Dosje të tenderit në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 & 9.2, për paken e kërkesës nr.4 .Kërkesat Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisje teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit; Aneksin 10 të DT Dëshmia e kërkuar dokumentare.

4.Një listë të mjeteve apo pajisjeve teknike që janë në dispozicionin tuaj për të ekzekutuar kontratën në tjetër- pajisjet dhe makineria të dispozicion duhet të dëshmohen me kopje të librezave mbi pronësinë e tyre ose DUD-i doganor. Në rast të marrjes me qera duhet të dëshmohet edhe një kontratë mbi qeramarrjen,

GOE-ik: për këtë pikë të kërkesës me ofertën e tyre nuk ka dorëzuar listën e mjeteve dhe pajisjet Teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit

- Me ofertë nuk ka dorëzuar sigurim të tender sipas kërkesës së DT-së.

-Kërkesa Ju lutem ta plotësoni edhe ANEKSIN 7 sa i përket afatit të implementimit të projektit dhe periudhës garantuuese, i cili aneks është pjesë e kësaj dosje dhe me ofertën e tyre nuk është plotësuar ky Aneks siç është kërkuar.

Parashtruesi pretendon që ka dorëzuar të gjitha dëshmitë dokumentare që janë kërkuar me DT dhe është eliminuar padrejtësisht. Ky fakt nuk qëndron sepse oferta e parashtruesit është dorëzuar përmes e prokurimit dhe të gjitha dokumentet që janë dorëzuar në këtë ofertë janë të regjistruara në platformën e prokurimit. Tutje në këtë ofertë të parashtruesit ekziston një folder i titulluar "sigurimi" dhe nëse hapet ky folder evidentohet vetëm një faqe A4 e zbrazët me ngjyrë të bardhë.

Në UPP pika 10 theksohet që në rastet kur mungon sigurimi i tenderit, oferta duhet të refuzohet pa kërkuar fare sqarime shtesë.

Sigurimi 1 Tenderit mungon apo nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesë e DT Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtijshëm.

Pra vetëm për faktin që mungon sigurimi i tenderit, oferta e parashtruesit automatikisht duhet të eliminohet si e papërgjegjshme pavarësisht dokumenteve tjera në ofertë.

Përndryshe edhe të gjeturat tjera të komisionit vlerësues, pasi që në ofertë nuk është dorëzuar fare aneksi 7 për implementimin e projektit, dëshmitë dokumentare lidhur me pajisjet, si dhe dokumentet tjera sikurse janë evidentuar në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar - parashtruesit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 09.09.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0840/2025, ndërsa me datë 17.09.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0840/2025 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK nuk ka dhënë përgjigje rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesit dhe

dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Komplast 1985” SH.P.K ekspertit shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0840 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, ka parashtruar ankese ne OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues, nuk i ka respektuar kryesisht dispozitat e nenit 59 te LPP-se.

Pas përfundimit te vlerësimit te ofertave AK-Komuna e Prishtinës, me datën 12.08.2025 e njofton OE ankues, me letrën standarde të tenderuesit te eliminuar, te cilin e eliminon me arsyetimin si me poshtë:

OE ankues, lidhur me tri arsytet e eliminimit te cekura me larte, pretendon se nuk janë ngarkuar për shkak te problemeve teknike me rrjetin që kemi pasur dhe pretendon se AK, me këtë rast nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 59 dhe 72 te LPP-se.

Eksperti shqyrtues sqaron se për dëshmitë lidhur me pajisjet mund te kërkohen sqarime siç pretendon OE ankues, ndërsa për sigurimin e ofertës nuk mund te kërkohen sqarime sepse sipas paragrafit 2 te nenit 72 te LPP-se, AK mund te kërkojë sqarime për dokumentet e paraqitura në pajtim me dispozitat e nenit 65 dhe 71 te LPP-se, ndërsa sigurimi i ofertës bën pjese ne nenin 57 te LPP-se. Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se me te drejte e ka eliminuar autoriteti kontraktues sepse OE ankues e ka ngarkuar si folder por është i zbrazet. Poashtu sipas rregullores për prokurim publik, lidhur me sigurimin e ofertës, nuk mund te kërkohen sqarime shtese sepse kualifikohet si kusht administrative.

OE ankues, ne ankesën e tij, pretendon se OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm, sepse marrëveshja me gjeologun E. Hajra e dorëzuar ne ofertën e OE te rekomanduar për kontrate, nuk është valide sepse inxhinieri ne fjale është pjese e kompanisë tone dhe nuk është pjese e stafit te OE te rekomanduar për kontrate. Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë çështje fillimisht sqaron se inxhinieri ne fjale është pjese e anëtarit te 3-te te konzorciumit OE Kom Group Sh.p.k.

Autoriteti kontraktues, konkretisht komisioni vlerësues, lidhur me këtë çështje ka kërkuar qe te sqarohet me inxhinierin E. Hajra, sepse dëshmitë e inxhinierit ne fjale, gjenden ne dy ofertat pjesëmarrëse ne këtë aktivitet te prokurimit (ne ofertën e OE ankues dhe ne ofertën e te rekomanduarit për kontrate). OE i rekomanduar për kontrate, sipas kërkesës se AK-se është përgjigjur duke deklaruar se: Ne rastin konkret, është deklaruar pronari i kompanisë Kom Group dhe nuk është deklaruar inxhinieri i lartpërmendur. Ne ankese ne tij OE ankues, e ka bashkangjitur edhe një deklaratë me shkrim te inxhinierit E. Hajra i cili deklaron se:

Eksperti shqyrtues, bazuar ne shkresat e lendes, sqaron se AK nuk është dashur qe ta merr për baze deklaratën e pronarit sepse i njëjti nuk mund te përgjigjet për dikend tjetër. Megjithatë eksperti shqyrtues, vlerëson se gjate rivlerësimit te ofertave te obligohet autoriteti kontraktues qe te kërkojë sqarim direkt nga inxhinieri E. Hajra.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr

parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/saj, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paraqitura nga ankuesi lidhur me eliminimin e tij nga ky aktivitet i prokurimit, Paneli Shqyrtues konstaton se Operatorit Ekonomik ankues, në lidhje me tri arsyet e eliminimit të cekura në ankesën e tij pretendon se nuk i janë ngarkuar dokumentet për shkak të problemeve teknike me rrjetin, dhe se Autoriteti Kontraktues në këtë rast nuk i ka respektuar dispozitat e neneve 59 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Paneli Shqyrtues konstaton se AK do të kishte pasur mundësi që, në lidhje me dëshmitë për pajisjet, të kërkonte sqarime shtesë; megjithatë, gjendja faktike nuk do të kishte ndryshuar, për arsye se dispozitat ligjore të nenit 72 të LPP-së nuk gjejnë zbatim në këtë rast. Kjo për shkak se AK mund të kërkojë sqarime vetëm për dokumentet e paraqitura, në pajtim me dispozitat e neneve 65 dhe 71 të LPP-së, ndërsa sigurimi i ofertës rregullohet sipas dispozitave ligjore të nenit 57 të LPP-së.

Gjithashtu, sipas dispozitave të Rregullores për Prokurim Publik, në lidhje me sigurimin e ofertës, nuk mund të kërkohen sqarime shtesë, pasi ky konsiderohet si kusht administrativ dhe jo teknik.

Në lidhje me pretendimin ankimor që ka të bëjë me inxhinierin Florim Hajra, Paneli Shqyrtues konstaton se në ofertën e Operatorit Ekonomik të rekomanduar ekziston dokumentacion i dorëzuar për këtë inxhinier, konkretisht: CV-ja, diploma e noterizuar si dhe kontrata mbi vepër e lidhur ndërmjet OE-së së rekomanduar dhe inxhinierit më datë 25.06.2025, për aktivitetin në fjalë, sipas titullit të kontratës.

Andaj, nëse siç pretendon OE ankues ky inxhinier është pjesë e stafit të kompanisë së tij, Paneli Shqyrtues konstaton se një pretendim i tillë është jashtë kompetencave dhe autorizimeve të tij për ndërmarrjen e veprimeve përkatëse ndaj veprimeve të ndonje anetari si pjese e stafit te ndonje OE.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka

vepruar në harmoni të plotë me dispozitat ligjore në veqanti me dispozitën e nenit 6 të LPP kështu duke kursyer paranë publike.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit e sheh si pjesërisht të bazuar, kështu duke vërtetuar njloftimin lidhur me aktiviteti i prokurimit me “141 Ndërtimi i sistemit të ujitjes në hapësira gjelbëruese dhe hapja e puseve” me nr. të prokurimit: 616-25-3717-5-1-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Komplast 1985 SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: